

HIDROFOB T

Aditiv për hidroizolim e betonit dhe llaçeve

Në përputhje me: EN 934-2:T9

FUSHA E APLIKIMIT

Si aditiv për betone, parandalon depërtimin kapilar të ujit nëpër seksionet e betonit, duke e bërë betonin të padepërtueshëm nga uji. Rrit qëndrueshmërinë dhe rezistencën e betonit të destinuar për kontakt të përhershëm me ujin dhe lagështinë. Rekomandohet për objekte që janë në kontakt me ujin, akullin dhe kripërat për shkrire dhe ekspozim ndaj karbonizimit, si psh. ndërtesat nëntokësore, portet, rezervuarët, themelet, muret mbajtëse etj. Përdoret në ndërtimin e strukturave nëntokësore të papërshkueshme nga uji sipas sistemit të "vaskës së bardhë".

CILËSITË

- Mundëson mbylljen e mikroporeve në beton, duke parandaluar kështu thithjen kapilare të ujit dhe substancave të dëmshme në strukturën e betonit;
- Rrit rezistencën e betonit ndaj depërtimit të ujit nën presion;
- Redukton thithjen kapilare të ujit përmes seksioneve të betonit;
- Parandalon depërtimin dhe migrimin e klorureve nëpër beton;
- Redukton karbonizimin e betonit;
- Rrit qëndrueshmërinë e betonit në kushtet e ekspozimit ndaj akullit, kripërave dhe koncentrimin të lartë të CO₂-shit;
- Parandalon shfaqjen e "kripesjes";
- Lejon aplikimin e mbështjelljeve (lyerësve) dytësore mbrojtëse dhe dekorative;

KARAKTERISTIKA TEKNIKE

Cilësi	Metoda	Vlera e deklaruar
Pamja	Vizuele	Lëng ngyrë kafe
Masa e volumit (në 20°C)	ISO 758	(1.18±0.03) g/cm ³
pH-vlera (në 20°C)	ISO 4316	4±1
Përmbajtja e klorureve	EN 480-10	≤0,1%
Përmbajtja e alkaleve	EN 480-12	≤2,0%

DOZIMI DHE PERFORMANSAT:

Hidrolob T dozohet gjatë përgatitjes së betonit në përzierjen e betonit të freskët. Doza e rekomanduar është 0,7-2,0% e peshës në raport me masën e çimentos.

Për të arritur performancë të lartë hidroizolimi, rekomandohet që Hidrolob T të aplikohet në beton në shkallë mbi 30 MPa. Me këtë rast, është me rëndësi të veçantë që procesi i plotë i përgatitjes, transportit, hedhjes dhe kujdesit të betonit të jetë në përputhje me kushtet e ndërtësës. Betonimi (veçanërisht te pllakat masive të themeleve) duhet të bëhet në mënyrë kontinuele pa ndërprerje dhe shtresat pasuese të betonit duhet të rivibrohen mes vete. Në rastet kur punohet në kushte të rritjes së temperaturave të ambientit, rekomandohet kombinimi i Hidrolob T-së me aditivë nga grupi i plastifikuesve dhe superplastifikuesve ose në mënyrë alternative përdorimi i lëngut Hidrolob. Gjithashtu është e nevojshme të merren masa të kujdesit për betonin e freskët (mbulim, spërkatje me ujë ose përdorim të mjeteve të posaçme mbrojtëse).

Efektet e mbidozimit: Në rast mbidozimi, mund të ndodhë një humbje e papritur e punueshmërisë së betonit të freskët.

Fq. 1 nga 2

KOMPATIBILITETI

Hidrofob T është kompatibel me disa aditivë nga programi ADING. Hidrofob T është kompatibel me të gjitha llojet e çimentove Portland duke përfshirë çimento rezistente ndaj sulfatit.

Për të arritur performancë të lartë të sipërfaqeve të betonit hidroizolues dhe refuzues të ujit, rekomandohet aplikimi i Hidrofob T-së në kombinim me ndonjë nga aditivët e grupit të plastifikuesve ose superplastifikuesve. Aditivët e ndryshëm në beton dozohen veçmas, pra nuk përzihen me njëri-tjetrin përpara se të hidhen në përzierjen e betonit.

PAKETIMI

Kanta plastike: 5 kg, 20 kg dhe 25 kg

Fuçi: 240 kg

Kontejnerë: 1200 kg

RUAJTJA NË DEPO

Në paketimin original, në një temperaturë prej 5°C deri në 35°C dhe të mbrojtur nga ndikimi direkt i rrezeve të diellit. Afati i përdorimit: 24 muaj.

SHENJA E CERTIFIKIMIT TË PRODHIMIT

	
2032	
ADING AD Shkup Novoselski pat (rruga 1409) nr. 11, 1060 Shkup, Maqedoni 14	
GAEB001/6	
EN 934-2:2009+A1:2012	
HIDROFOB T	
Aditiv për hidroizolim të betonit EN 934-2:T9	
Përmbajtja e joneve të klorit	≤ 0,1% sipas masës
Përmbajtja e alkaleve	≤ 2,0% sipas masës
Veprimi koroziv	Përmban komponentë vetëm të EN 934-1:2008-shit, Aneks A.1

Rreziku për shëndetin: Hidrofob T nuk përmban substanca toksike, por përkundër kësaj, duhet pasur kujdes që materiali të mos bie në kontakt me lëkurën, sytë ose të gjëllitet. Në rast kontakti me lëkurën ose sytë, është e nevojshme të shpëlahet menjëherë me ujë të pastër të rrjedhshëm. Nëse gjëllitet, kërkoni kujdes mjekësor. Informacion shtesë jepet në Fletën e Sigurisë së produktit.

Zjarri: Hidrophob T është substancë në gjendje të lëngtë që nuk ndizet. Informacion shtesë jepet në Fletën e Sigurisë së produktit.
Pastrimi dhe deponimi: Mbetjet e Hidrofob T-së pastrohen me ujë. Paketimi i vjetër i përdorur duhet të hidhet sipas rregulloreve lokale për atë lloj mbeturinash. Informacion shtesë jepet në Fletën e Sigurisë së produktit.